Arrestohet personi që tentoi të grabiste me armë një institucion mikrofinanciar në Prizren

KRONIKA May 05, 2023 - 11:54

SHPËRNDAJE:

Më 03.05.2023, rreth orës 16:04 , në Stacionin Policor Prizren raportohet për rast "Grabitja në tentativë" në rr. "Ahmet Prishtina".

This site

Një person i maskuar dhe i armatosur të mërkurën ka tentuar të grabiste institucionin mikrofinanciar "Finca" në Prizren.

Sipas Policisë, i dyshuari i rastit, i veshur me rroba sportive të zeza, me maskë në fytyrë dhe me pistoletë në dorë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, hyn në objektin mikrofinanciar 'Finca', ku konfrontohet me punëtorin e sigurimit të atyshëm, të cilit i shkakton lëndim ne kokë. Përpjekja e të dyshuarit për të kryer grabitjen ngel e papërfunduar. I dyshuari largohet nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur.

"Janë ndërmarrë veprime të duhura hetimore, në vendngjarje është gjetur një çelës i veturës i të dyshuarit e më pas edhe vetura të cilën i njëjti e ka pasur në përdorim, 'WV Passat', ngjyrë e zezë, e cila me urdhër të prokurorit është sekuestruar.

Është identifikuar i dyshuari D.G., në shtëpinë e të cilit me urdhër të prokurorit është kryer një kontroll (bastisje)", njofton Policia.

Në njoftim thuhet se dje rreth orës 21:50 i dyshuari është lokalizuar dhe është arrestuar.

"I njëjti intervistohet në prezencë të avokatit mbrojtës. Të dyshuarit i është gjetur në posedim një armë zjarri – pistoletë, e cila sekuestrohet. Është iniciuar rast i klasifikuar si vepër penale 'Grabitja në tentativë', ndërsa me aktvendim me shkrim të prokurorit të Shtetit, të dyshuarit i shqiptohet masa e ndalimit për 48 orë", thuhet në njoftimin e Policisë. **/Zëri**

Arma e sekuestruar

Taboola Feed

Radio e Jashtme e Kinës
CRI ofron shërbime të pasura audiovizive për audiencën në mbarë botën
CRI | Sponsored

Qetësoni dhimbjen e kockave dhe të muskujve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Vuçiq: Situata është në "prag konflikti", Lista Serbe po vjen në Beograd
Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq ka mbajtur një konferencë pas zhvillimeve të sotshme në Bruksel. Ai ka thënë se sipas informacioneve që ka nga inteligjenca, situata në veri të...
Zeri.info

Ja disa këshilla në lidhje me dhimbjen e kockave
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Të rekomanduara



Arrestohet personi që tentoi të grabiste me...
May 05, 2023

Vrasja e trefishtë në Gllogjan, Prokuroria sot...
May 05, 2023

Plagosja e djeshme në Prishtinë, i dyshuari ende në arrati
KRONIKA | May 05, 2023

Dy mëshkuj dyshohet se dhunuan një femër në Prishtinë, njëri arrestohet
KRONIKA | May 05, 2023

Vrasja në Dumnicë të Podujevës, prokuroria kërkon paraburgim për njërin nga të arrestuarit
KRONIKA | May 04, 2023

Gjakovë, arrestohet 18-vjeçari për posedim të paautorizuar të armëve
KRONIKA | May 04, 2023

Arrestohen tre prishtinas, dyshohen për vjedhje
KRONIKA | May 04, 2023

Dy prishtinas arrestohen në Morinë, në bagazh të makinës kishin futur një 17-vjeçare
KRONIKA | May 04, 2023

Më të lexuarat

KRONIKA | May 03, 2023
Të shtëna armësh mes policisë dhe një personi në Mirushë të Malishevës

KRONIKA | May 04, 2023
Arrestohet një kirurg në Spitalin e Prizrenit për trajtim të pandërgjegjshëm

KRONIKA | May 03, 2023
Vrasja në Podujevë: Arrestohen dy të dyshuarit

KRONIKA | May 03, 2023
Në Gjermani, vdes në aksident 59-vjeçari nga Kosova

KRONIKA | May 04, 2023
Aktakuzë ndaj ish-kryeshefit të Telekomit, dyshohet se dëmtoi ndërmarrjen për 6 milionë euro

KRONIKA | May 04, 2023
Plagoset një person në Prishtinë, i dyshuari në arrati

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2010 Portali "Zëri".

redaksia@zeri.info
marketingu@zeri.info
Tel. + 383 38 24 90 71
Tel. + 383 38 22 24 51

Dev. **S.A.P** - Design: **Trembelat**

Ky portal mirëmbahet nga NGB "Zëri" sh.p.k.. Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimi, pa miratimin e drejtuesve të "Zëri". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali, obligohemi t'i pranoni Kushtet e përdorimit.